

NJOFTIM
Nr. 4878/1, datë 22.11.2023

RISHPALLJE PËR KANDIDIM
PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË
STATISTIKAVE, PËRFAQËSUES I ORGANEVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE

Në mbështetje të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, dhe të pikës 2, të vendimit nr. 670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e për zgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, shpallim njoftimin për kandidim për anëtar të Këshillit të Statistikave.

Konkurrimi është i hapur për përfaqësuesit që u përkasin **organeve të vetëqeverisjes vendore**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtar të Këshillit të Statistikave, përfaqësues të organeve të vetëqeverisjes vendore, janë, si më poshtë vijon:

Kandidati për anëtar, përfaqësues i organeve të vetëqeverisjes vendore:

- i. të jetë nga radhët e nëpunësve të këtyre organeve;
- ii. të ketë për natyrë pune përdorimin e statistikave;
- iii. të ketë punuar në fushën e përdorimit të statistikave, për shkak të detyrës, për jo më pak se 3 (tre) vjet.

Kritere të përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të jetë person i padënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënime me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

Shënim. Kandidatët për anëtar në Këshillin e Statistikave duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin që provon plotësimin e kriterëve, sipas këtij njoftimi.

Afati i dorëzimit të aplikimit është deri më 11.12.2023 dhe të dorëzohet në adresën e Kryeministrit. Kandidatët e kualifikuar do të njoftohen nëpërmjet *e-mail*-it.

Adresa: Kryeministria
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1000
Tiranë, Shqipëri
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Tel.: 04 22 77 401